

KURBINI ASET KOMBËTAR, OAZ VLERASH ETNOHISTORIKE, ETNOKULTURORE LINGUISTIKE DHE SHTETFORMUESE I PA VLERËSUAR

Nikollë Gj. LLESHI

Studiues, Etnolog, Muzeolog

Akademia "Rrenjet Tona"

PËRMBLEDHJE

Tema shtjellon argumentet ndërlidhëse Shkencore e Historike, madje pse jo edhe Etnokulturore, historike Linguistike dhe shtetformuese mbi mosnjohjen e deritanishme nga dijetarët tanë të një KUARTETI shkencor ngjarjesh të rëndësishme Regjionale e kombëtare, në fushën e Linguistikës, Historisë dhe Shtetformimitin e shqiptarëve, si: 752 vjetorin e mësonjëtores së parë të gjuhës shqipe me 20 Prill 1270, në Kishën e Shën'mërisë në Sebastie të Lacit në Kurbinin prehistorik, regjion ky, që daton që në shekullin e III-të para Krishtit me qytetin e tij të Latios, gjithashtu me një event tjetër, 311 vjetorin e themelimit të Katedrës së parë të Gjuhës Shqipe, e themeluar në Romën e qytetruar nga Akademiku dhe Teologu kurbinas Gjon Francesk Albani, Papa Klementi i XI-të me 20 Prill të vitit 1711. Në këtë kumtesw do të paraqesim sot edhe kontributin e kurbinasve për formimin e Shtetit të parë të Arbërit, të cilin e njohim të formuar më 1190-1271 me në krye Princin kurbinas Progon Gjonima, ku pasuesit e tij e mbajtën në këmbë këtë shtet për 81 vite. Një event i rëndësishëm për zhvillimet shkencore të linguistikës shqiptare ndër shekuj është dhe hapja e Katedrës së parë të Gjuhës shqipe nga kurbinasit në Romën e qytetruar që më 20 prill të vitit 1711 nga Gjon Francisco Albani Kurbinas, Papa Klementi i XI-të.

Fjalë kyçe: oaz, aset, shtetformuese, kurbinas

ABSTRACT

The topic elaborates the connecting scientific and Historical arguments, even if not Ethnocultural, historical Linguistic and state-building on the lack of recognition by our scholars of a scientific QUARTER of important regional and national events, in the field of Linguistics, History and State formation of Albanians, 75: the anniversary of the first Albanian language classroom on April 20, 1270, in the Church of the Assumption in Sebastia of Lac in the prehistoric Kurbin, this Region, which dates back to the 3rd century BC with its city of Latios, also with another event, the 311st anniversary of the founding of the first Department of the Albanian Language, founded in Rome by the civilized Academician and Theologian of Kurbin John Frances Albani, Pope Clement XI on April 20, 1711. In this paper we will present today also the contribution of the Kurbinians for the formation of the first State of Arbër, which we know formed in 1190-1271 headed by the Prince of Kurbin Progon Gjonima, where his successor he's kept this state afloat for 81 years. An important event for the scientific developments of Albanian linguistics over the centuries is the opening of the first Chair of the Albanian Language by the Kurbinians in civilized Rome on April 20, 1711 by John Francisco Albani Kurbinas, Pope Clement XI.

Key words: oasis, asset, statehood, native born

HYRJE

Si fillim i këtij kumtimi, më lejoni tju them sinqerisht se do të isha i lumtur, në se nuk do të mërzitej askush sot në këtë mjedis diturakësh duke më dëgjuar, për këto Artefakte të pa thëna kurrë për vendlindjen time të dashur, KURBINI SHQIPËRIA IME, të cilit i kam kushtuar terë jetën dhe atë pak

pasuri që kam pasur, mbasi Kurbini prehistorik daton që në shekullin e tretë para Krishtit me qytetimin e tij, e si i tillë ky është një Aset kombëtar për vlerat që mbart në vetvete e besojmë fort, se jo gjithkush e din këtë madhështi historike kombëtare që kemi të gjithë ne bashkërisht e kombëtarisht, prandaj dhe e kemi quajtur Kurbinin, ASET KOMBWTAR, një oaz etnohistorik vlerash i pa vlerësuar nga dijetarët tanë, sa dhe si duhet deri tani. Duke ju falenderuar të gjithëve për nderin që na bëni me dëgjesën tuaj, më lejoni të argumentoj sot para jush shkurtazi shkencërisht e historikisht, se Kurbini duke qenë pjesë ekzistente sa vetë toka e këtij kombi, e kësaj treve gjeografike në shqipërinë e mesme por fatkeqësisht në këto vite pseudodemokratike, Partiokracia e spostoji juridikisht Kurbinin në Shqipërinë e Veriut, duke harruar këta Partiokratë, se Kurbini përveqse gjërave të përbashkëta kobtarisht, nuk ka asgjë Etnohistotike, Linguistike e qytetruese me Shqipërinë e Veriut, sepse ajo ka qenë pjesë gjeografike dhe qytetruese e shqipërisë së mesme të cilën Natyra Zot e ka ndarë prej shekujsh atë nga shqipëqria e Veriut me Lumin Mat e atë shkumbin, sepse Kurbini ndër shekuj, prej mijëra vitesh ka pasur Etnokulturën, Etnohistorinë Linguistikën dhe qytetimin e vet, që në shekullin e tretë para Krishtit, e për këtë arsye, Kurbini ndër shekuj i ka dhënë kombit Arsimim dhe figura të mëdha të përbotëshme, madje pse jo edhe shtetformimin, i cili u pasua prej më se 832 vite shtet, duke filluar nga shtetformimi i Arbërit më 1190 nga Kurbinasit e deri në ditët e sotëshme me ndërprerjet e veta historike nga pushtimet e ndryshme që ka pësuar ky vend e ky popull kaq i lashtë e qëndrestar.

Fatkeqësisht, për të gjitha këto madhështi kombëtare që ka Regjioni i Kurbinin, deri tani nuk është thënë nga dijetarët tanë kombëtar, se përse i janë humbur kombit tonë deri tani mbi 752 vite vjetërsi të Gjuhësisë e Qytetimit kombëtar Arbëror të kurbinasve, që burojnë që nga shekullin e tretë para Krishtit, atëhere kur në Regjionin tim nuk ekzistonte as qyteti i Krujës, i cili për më se 700 vite, që nga pushtimi turk e deri me ardhjen e Demokracisë, Edhe Kruja e mbajti Kurbinin pa autonomi, që prej asaj kohe kur ndoshta nuk kanë ekzistuar shumë qytete të Shqipërisë së sotëshme. Mjafton të përmendim një fakt të hidhur e poshtërues ndaj kurbinasve se për shkak të varësisë së padrejtë të Kurbinin nga Kruja, ata poserdojnë në varrezat e tyre mbi 100 varre të deshmorëve e heronjëve kurbinas, ndër vite e shekuj e Partiokracia në pushtet ende nuk i ka dhënë të drejtë kurbinasve që të marrin të vdekurit e tyre dhe ti vendosin në teritorin e vet kurbinas. Akoma më keq kanë vepruar Partiokratët e sotshëm me poshtërimin e kurbinasve, kur padrejtësisht e kanë kaluar kurbinin në varësi të Lezhës, kur kurbini bën pjesë në shqipërinë e mesme dhe jo atë të veriut. Por ja që vjen në ditë, e historia flet me gojën e vet të një provincieri të nenvleftësuar e nepërkëmbur për dekada të tera, nga Partiokracitë e ndryshme ndër vite,ku përveqse Hajnisë, ata nuk kanë pasur asgjë kombëtare në shpirtin e tyre, por ata, nepërmjet instrumentit të rrezikshëm kulturisht, të Heshtjes, që është Varrëmihsja e Meritokracisë, Inteligjencës dhe Humanizmit njerëzor, të atyre njerëzve që sosin terë jetën e pasurinë e tyre për At'Dhetari, në këtë shqipërinë tone të Artë, duke hargjuar tërë kohën dhe pasurine e vet, për te nxjerrë në pah vlerat kombëtare të Racës së ARTË shqiptare, si kundër jemi edhe pjesë e kësaj pleiade të ndeshkuarish e të mosvlerësuarish.

E kundërta ka ndodhur ndër vite e shekuj, ndërsa shumkush tjetër nga Partiokracia kombëtare, që sot e mendojnë gabimisht veten si më të diturit e botës, shkrinë dhe shet vlerat e rracës së vet për ti zhvatur kësasaj shqipërie, shumcka nga pasuria e saj universale e lënë prej etërve tanë prej mijëra vitesh. E di se dikush mund të thotë që ky denoncim është i rrezikshëm individualisht, por fakti është se ne jemi mësuar për ti berë ballë me guxim, padrejtësisë shoqërisht të rrezikëshme. Jam i lumtur sot që mu dha mundësia në këtë përvjetor të figurës legjendare kombëtare Gjergj Kastrioti Skendërrbeu, si një nga vazhduesit e shtetformimit të shqiptarëve, që sot unë para jush të paraqes në këtë referat madhështinë e mohuar të vlerave kombëtare të Kurbinin Shqipëria ime. Pikërisht në këtë ditë të shejtë për mua, unë do ta nis referatin tim, atje në atë pikë dhembjeje shpirtërore për mosvlerësimin kombëtarisht të njerës nga pasuritë e rralla kombëtare, pa të cilën ne nuk mund të quhemi komb, e pikërisht me 752-vitet e

ekzistencës së gjuhës shqipe në Kurbin, për tju deklaruar me përgjegjësi arkivore e shkencore të gjithë Skeptikëve, se ne duke udhëtuar me syrin e mendjes, mijëra kilometra dhe duke shfletuar dokumentet arkivore në Vatikan e në shtete të tjera të Botës si në Stamboll, Vjenë, Beograd, Zagreb, Athinë, etj. kemi mundur që të shikojmë me kënaqësinë e shpirtit ,shenime të kronistëve e Albanologëve të ndryshëm të ardhur nga thellësia e shekujve, për Etnohistorinë, Etnokulturën dhe Linguistikën e Shqipërisë, këtij vendi të lashtë sa vetë toka, madje shumcka mbi vjetërsinë e shkollës shqipe të vitit 1270 , në kishën e Shën'mërisë në Sebastie të Lacit në Kurbin, për ekzistencën e së cilës ne do të japim argumente shkencore shterruese, për tju thënë skeptikëve kurbinas, kombëtar dhe atyre ndërkombëtarë, se shkrimi i shqipes së parë është në Sebastie të Lacit në Kurbin dhe askund tjetër në Shqipëri.

GJUHA SHQIPE ËSHTË SHKRUAR QË PARA SHEKULLIT XIII-TË

Gjuha shqipe është shkruar që para shekullit XIII-të në kohën e Shtetit të parë të Arbërit, më 1190” dhe që njihet deri në pjesën e dytë të shekullit XIII më 1270 por fatkeqësisht, vetë ne shqiptarët, deri tani jo se nuk i kemi njohur këto fakte, por se nuk kemi dashur ta pranojmë këtë madhësi që ka kombi ynë nepërmjet Kurbininit. Ashtu sikundër Cekëm,edhe më lart, studiuesja dhe albanologia me famë botërore Edit Durhan ka shkruar më tej në studimin e saj Albanologjik, duke shtuar përveqse ekzistencës mijëra vjeqare të gjuhës shqipe, në Kurbin, edhe fakte të tjera mbi shtetformimin e shqiptarëve nga Kurbinasit, duke theksuar në veprën e saj për shkrimin e shqipes nga shqiptarët, madje dhe për formimin e shtetit të parë të Arbërit, duke sanksionuar shkencërisht e historikisht se: Gjuha shqipe është shkruar që në shekullin XIII-të në kohën e shtetit të parë të Arbërit, të cilin e njohim të formuar më 1190 me princin kurbinas, Progon Jonima dhe se Divasi që njihet për dinastinë qytetare të banorëve të saj,të zbritur nga Kështjella e Latios, pas shkatërrimit të kështjellës së Latios nga barbarët, aty afër vitit 520, këta banor gjatë viteve 525-567 patën zbritur dhe ndërtuar qytetin e tyre të Divasve poshtë Sebasties. Është shumë interesante të shikohet në ato shenime arkivore, në të cilat shpjegohet, se asokohe gjatë viteve 527-567, Qyteti i Divasve në Lac të Kurbininit në atë periudhë të hershme ka pasur një zhvillim shumë të madh Kulturorë, Tregtar dhe Ekonomik me Venedikun, i cili mendojmë se e ka zanafillen e tij të zhvillimit e qytetimit, që në periudhën e Perandorëve Bizantinë, Anastas dhe Justiniani i parë më 527-567 të cilët, në atë periudhë patën marrë një seri masash fortifikuese në Shqipëri për të mbrojtur perandorinë e tyre nga sulmet Barbare –Sllavo-Bullgare, edhe kundrejt shqiptarëve. Këta sundimtarë dhanë edhe një kontribut të jashtëzakonshëm në Ripërtëritjen e qytetit të Divasve më 527-567. Duke shfletuar shenimet historike Albanologjike në arkivin qëndror të Vatikanit, ne do të shikojmë se Arqipekvi i Tivarit, një pëshkop Frëng, i quajtur Gullielmus Adae, i njohur përgjithësisht me emrin Brocardus Monacus, më 1332 do të shkruante në veprën e tij për gjuhën shqipe se: Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga Latinishtja, me gjithë se, ata kanë alfabetin Latin. Albanologia Edit Durhan, në studimin e saj të thelluar të mëvonshëm,shkon akoma më tutje kur komenton Adaen, duke na shpjeguar shkencërisht edhe situata të reja për gjuhën shqipe se:

Letërsia dhe Gjuha shqipe

Letërsia dhe Gjuha shqipe, ka filluar të shkruhet që në shekullin e XIII në kohën e shtetit të parë të Arbërit, i formuar në Kurbin më 1190 ndoshta dhe më heret, (thekson ajo) sepse në të shkruarit shqip


në Sebastien e asokohshëm është gjetur edhe origjinali i veprës letrare Meshari, e shkruar nga Gjon Buzuku. Ne duke ndjekur hap mbas hapi zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë në Kurbin ndër vite e shekuj, madje për gjetjen e MESHARIT të Gjon Buzukut në Sebastie, fatmirësisht në arkivin e Vatikanit kemi gjetur një shenim interesant , i cili përligj të gjitha definicionet që ka dhënë studiuesja dhe albanologia me famë botërore për Albanologjinë shqiptare Edit Durhan. Ky dokument arkivor thotë se: “Kopja e vetme original e Mesharit të Gjon Buzukur, mendohet të jetë shkruar dhe të këtë dalë nga Laci i Sebasties në Kurbin të Shqipërisë, nga Kisha e Shënmerisë që gjendej atje”. 6/1 SHIH:Marin Bici Relacion i vitit 1610, v.1.Dokumenti N:2 faqe 49-241 arkivi i Vatikanit. Duke vazhduar më poshtë, në këtë dokument historik të rrallë,dhe shumë të rëndësishëm për shqipërinë dhe shqiptarët, Albanologia Edit Durhan shpjegohet se: Kurbinin në rrjedhën e shekujve, nepërmjet qytetimit të Latios e më vonë atë të Divasve në Sebastie të Laçit, i dha kombit, Korithenjë të mëdhenjë në fusha të ndryshme të Artit, Kulturës, Gjuhësisë, Foklorit, Filozofisë, dhe Teologjisë së Krishterë, duke e kthyer kurbinin në një qendër arsimore dhe etnokulturore të Arbërit. Duke u nisur nga kwo fakte,ne argumentojmë shterrueshëm, sepse duke shfletuar arkivat, da del se në Kurbin që në fillim të shekullit të parë, ku sapo verbalisht nepër botë kishte filluar Doktrina e Krishterë, do të shfaqej në popullin e Arbërit dhe pikërisht në shqipërinë e mesme dhe në Lac të Kurbinin aty rreth viteve 50 -60 do të krijoheshin rreth 60 familje të Krishtera në shqipërinë e mesme, ku dhjetë prej tyre ishin në Kurbin. Pikërisht në Kurbin asokohe ishin krijuar dhjetë familje të krishtera duke braktisur Paganizmin e vjetruar. Mendojmë se kishte ndodhur, që fillimisht kjo dotrinë e Krishterë, do të hynte në Kurbin, nepërmjet mendëtarëve të shkolluar në shkollën e Kurbinin dhe teologëve të shumtë kurbinas të shkolluar asokohe në Vatikan, si një doktrinë që kishte lindur nga filozofët e kohës, si nevojë për të shpëtuar njerëzimin nga Regjimi POLITEIS. Tani dukej se Bota e civilizimit njerëzor nepërmjet Filozofisë së Krishterë, të sapolindur do të përplasej për jetë a vdekje me Botën e Politeizmit moral, me Paganizmin në thelb.

Ishte përkrahur kjo doktrinë nga dinastia dhe njerëzit shpirtëmëdhenjë kurbinas nw Sebastie dhe nw Divas, sepse ishin të bindur, se Krishtërimi synonte të rrënjoste mes njerëzish: dashurinë, bashkëjetesën dhe harmoninë njerëzore. Është shumë interesante, madje jashtëzakonisht dhe i vlefshëm kombëtarisht të studiohet nga dijetarët tanë shkencor të Albanologjisë dhe Linguistikës kombëtare, në Arkivin Qëndror të Vatikanit, një relacion i një murgu anonim, që kishte shërbyer osokohe gjatë vitit 1270 në kishën e Shënmerisë në Sebastie të Kurbinin, i cili na ka lënë një ARTEFAKT Linguistik të rrallë kombëtar, e ndërkombëtarisht të jashtëzakonshëm e vlerësueshëm për shqipërinë dhe shqiptarët, në të cilin ai verteton shkencërisht e historikisht se:



Në kishën e Shën'mërisë në Sebastie të Lacit në Kurbin gjatë gjithë periudhës së më hershme, para vitit 1270 e deri në vitin 1641 ka funksionuar mësonjëtorja e gjuhës shqipe për fëmijët e dinastisë kurbinase, e cila nxirrte seminaristë për ti mësuar popullit të shkruarit e shqipes. Kjo mësonjëtorë ju mësonte fëmijëve shkrim, Këndim, Arithmetike dhe Astronomi.

Duke ndjekur shenimet arkivore hap pas hapi do tw shikojmw se Pjetër Budi, në relacionin e tij drejtuar Kardinalit Gocodono shkruan se: ‘ Për fëmijëve shqiptar, në këtë periudhë pushtimi të Verilindore nga Serbët, ma së parit është e domosdoshme që atje në Sebastie të themelohet veqmas shqiptar për studimin e shqipes një kolegji me 16



shkollimin e shqiprisë

për fëmijët nxënës që

duhet të ndrihet në Sebastie të Kurbinit në Shqipëri.” Shenime këto që mund të gjenden.

Së këndejmi duket sheshit se, për 471 vite, Sebastia e Kurbinit paska prodhuar seminaristë në gjuhën shqipe. Që në shekullin e tretë para Krishtit paska patur edhe Dinasti qytetare, ndërsa skeptikët kurbinas dhe të huaj mundohen ta errësojnë këtë fakt historik me vlera të jashtëzakonshme kombëtare, dhe ne heshtim për madhështinë e gjuhës dhe inteligjencies sonë të vjetër kombëtare, si një nga gjuhët dhe Inteligjencia më të vjetra të botës, madje dhe qytetrimi ndër më të vjetrit në Europë, ndërsa quditërisht disa skeptikë e paraqesin kombin tonë si një komb jo i qytetruar duke harruar se kombi shqiptar në saje të qytetimit të tij të lashtë, ka pasur edhe Mbretëresën Teuta që p.e.s. Po si mendohet nga skeptikët shqiptar apo të huaj, që Teuta Ilire, Burrënesha e parë e kombit tone, është berë që në vitin 231 para erës sonë, mbretëreshë në Iliri, ndërsa quditërisht disa skeptikë e paraqesin kombin tonë si një komb jo i qytetruar. Po si mendohet nga skeptikët shqiptar apo të huaj që Teuta Ilire, Burrënesha e parë e kombit tone, është berë që në vitin 231 para erës sonë, mbretëreshë në Iliri. A mund të bëhet Mbretëreshë një femër pa patur Dinasti kulturore e qytetare ky popull që në lashtësi. Duke shfletuar arkivat e ndryshme në Vatikan e gjetk, ashtu si edhe në Institutin e Gjuhës në Tiranë, quditërisht shikojmë se kjo shqipe e shkruar në Kurbin që në vitin 1270 dhe ky qytetrim në Sebastie, është parë nga studiuesit tanë shqiptar, sepse përbri cdo skede arkivore ka dhe emrin e studiuesit. Edhe në skedat arkivore në Vatikan, theksohet, se gjuha shqipe e shkruar në Kurbin ka qenë evidente në Sebastie të Kurbinit para vitit 1270, në Kishën e Shën'mërisë në Sebastie, por nga askush nga gjuhëtarët tanë, të cilët paskan qenë të detyruar që të lënë emrin e tyre pranë cdo skede, nuk ka folur ndër vite, madje dhe shekuj.

Për këtë saktësim, Studiuesja Edit Durhan, në studimin e saj të thelluar të mëvonshëm, ajo bën përcaktimin shkencor të saj, duke argumentuar shkencërisht në veprën e saj për shkrimin e shqipes nga shqiptarët, ashtu edhe për formimin e shtetit të parë të Arbërit se: Princi kurbinas Progon Jonima. Gjuha shqipe është shkruar që në shekullin XIII-të në kohën e shtetit të parë të Arbërit, të cilin e njohim të formuar më 1190 me në krye Princin kurbinas Progon Gjonima, dhe që njihet deri në pjesën e dytë të shekullit XIII më 1272. 82 vite shtet, thekson ajo. Tani na lind një pyetje e cuditëshme: Po si ka mundësi që dijetarët tanë i paskan lexuar të gjitha këto dokumente historike arkivore dhe të mos e pranojnë dhe tju humbin shqiptarëve 82 vite shtet të Arbërit pothuaj se një shekull, duke mos i popullarizuar këto vlera këta studiues, për shkak të ingranimit të tyre në Partiokracitë shtetrorë të viteve e shekujve, të cilët i kanë detyruar studiuesit që të heshtin, për vlerat e kombit? Parë në këtë këndvështrim them me shpirt se mirë kam berë që nuk i jamë nënshtruar asnjë Partiokracie në jetën time, me qellimin e madh që një ditë unë ta them shkoqur të vërtetën historike për vendlindjen e etërve të mi, Kurbinin Shqipëria ime.

Vjetërsia e gjuhës shqipe

Në këtë studim, ne konfirmojmë jo vetëm vjetërsinë e gjuhës shqipe të shkruar me 1270 në Kishën e Shën'mërisë në Sebastie, si 752 vjetorin e saj të sotshëm, por edhe shtetformimin e Arbërit në Kurbin më 1190, 832 vjetorin e shtetit të parë të shqiptarëve, cka deri më sot, askush nuk ka guxuar, apo nuk ka dashur që ta thotë me përgjegjësi shkencore, se në Kurbin, asokohe paskesh qenë formuar dhe shteti i parë i Arbërit, por quditërisht, u dashka ta thonë të tjerët për neve kurbinasit e shqiptarët, ndërsa studiuesit skeptikë shqiptar mundohen që ta dërgojnë formimin e shtetit të Arbërit në thellësinë e alpeve tona, kur dihet se Arti, Kultura dhe shtetformimi i një kombi kanë lindur mes popujve të qytetruara, e të shkolluar, pikërisht në mes të Dinastive të qyteteve Kështjella dhe jo në shkretëtira. Madje, si mund të mendohet se është formuar një shtet në një vend që nuk ka asnjë kështjellë. Së këndejmi ne mund tju themi se Kurbinin ndwr shekuj ka patur si askush tjetër pesw kwshtjella. Vërtetimi i derisotshëm i ekzistencës në teritorin e Kurbinit të 5 kështjellave, provon edhe trimërinë,

ekzistencën e Dinastisë, Shtetformimin dhe atdhetarinë e kurbinasve ndër shekuj, madje dhe mosbindjen e tyre ndaj të huajëve zaptues, sepse nepërmjet këtyre kështjellave ai do ta mbronte vetveten nga sulmet barbare të kombeve të tjera. Parë në këtë këndvështrim, ne quditërisht kemi konstauar se në ato arkiva në Romë dhe në Shqipëri, janë të regjistruar të gjithë studiuesit shqiptar që i kanë marrë në dorë këto të dhëna historike të rëndësishme për vjetërsinë e kulturës gjuhësore dhe shtetformimit të kurbinasve, dhe zhvillimin kulturor gjuhësor e qytetar kombëtar të shtiptarëve, nepërmjet shkollës së Kurbinin më 1270 në Kishën e Shën'mërisë në Kurbin, madje dhe zhvillimin ekonomik të Divasve në Sebastie gjatë viteve 527-567, por cuditërisht, askush nuk i ka përjetësuar ato, duke e menduar Kurbinin si thotë populli im: Tatë i pa djalë, ndoshta edhe sepse vetë titullarët e sistemit të asokohshëm nuk donin ta thoshte askush këtë të vërtetë historike për Kurbinin dhe shqiptarinë, dhe shtrohet problemi që intelektualët ekselentë kurbinas, madje pse jo, edhe ata kombëtar duhet të rizgjohej dhe të flasin me forcë dhe kumbueshën në veshët e skeptikëve dhe të partiokracisë për madhësinë e etërve të tyre, në cdo cep ku banojnë shqiptarët, anë e kënd botës, e jo vetëm të shqipërisë, sepse kjo është detyra dhe ndershmëria intelektuale e studiuesëve, se ndryshe nuk mund që të rishkruhet drejt, historia kombëtare me militantë partishë, të komanduar nga Partiokracia e kohës. Ne gjatë studimit tonë duke parë përbri cdo skede arkivore në Vatikan, se aty bri saj shenohej emri i sejcilit studiues, madje dhe koha kur janë studiuar ato skeda, ne provojmë historikisht se të gjitha këto shenime vertetohen historikisht se i kanë parë ndër vite studiuesit shqiptar si:

1. Dhimitër Kamarda (1864)
2. Filip Matranga (1868)
3. Ermanno Aar (1888)
4. Zef Petrota (1890)
5. Pal Skiro (1909)
6. Zef Skiro Plaku (1932)
7. Jup Kastrati (1964 dhe 1980)
8. Dhimitër S. Shuteriqi (1965, 1976)
9. Rexhep Ismajli (1984)
10. Nikollë Gj. Lleshi (1999 dhe 2004)

Siqerisht na habit fakti se përse numri i studiuesëve të historisë tonë nëpër arkivave tanë e të botës, është më i madh nga Arbëreshët e Italisë, se sa i atyre të Shqipërisë dhe Kosovës të marrë bashkërisht. Kjo provon sigurisht që Shqiptarët e emigruar nëpër botë janë të pa implikuar nga Partiokracitë e shtetit shqiptar ndër vite e shekuj, madje dhe të sheteve ku banojnë dhe nuk i pengon njeri të studiojnë për Etnogjenezën e tyre.

Ne, si kurbinas, më shumë se 300 vite jetë të etnogjenezës sonë në atë vend të bekuar nga Zoti, themi kështu sepse si pas studimit tonë nga autoktonët e viteve 1270 të paktën në Lac, sipas Regjistrave kadastral turk të shekullit XV, por edhe të Vatikanit, kanë mbetur vetëm dy mbiemra autoktonë që prej asaj kohe të lashtë, si ai i MËRQINËS dhe i GJECIT. Unë si i fundmi i kësaj liste njohësish të këtyre artefakteve të vjetërsisë së gjuhës shqipe dhe të shtetformimit të shqiptarëve nëpër arkiva, me qellimin e madh të sensibilizimit kombëtar të këtyre të dhënave e artefakteve historike dhe linguistike për shqipërinë dhe shqiptarët, sepse këto vlera përveçse regjionale kurbinase, ato janë më së shumti

Asete kombëtare, mbas këtyre konstatimeve të drejtpërdrejta nga ana jonë në ato arkiva, ne duke qenë drejtues i Forumit intelektual; Kurbini, organizuam në Kurbin, një sesion shkencor me 20 Prill të vitit 2009- në Pallatin e Kulturës në Lac me temë: SHKOLLA E KURBINIT NË BALLË TË ARSIMIMIT TONË KOMBËTAR në të cilën, fatëmirësisht referuan Gjuhëtarët e nderuar Prof.Dok.Gjovalin Shkurti, Prof.Dok. Jup Kastrati, Akademiku nga Kosova Jashar Rexhepagic, Studiuesi kurbinas Nikollë Gjok Lleshi ,dhe disa studiues të tjer. Në fakt, tani më dukej vetja i lumtur, sepse të gjithë këta studiues, si në unison pentagramesh i pranuan dhe i deklaruan këto fakte arkivore historike, të cilat i patëm deklaruar ne në Referatin tonë kryesor, sidomos vendosmërisht Prof.Dok. Jup Kastrati, i cili në referatin e tij, ai e theksoi me forcë të qenurit e shkollës shqipe në Kurbin që më 1270, ashtu si edhe ne. Është në të mirë të sinqeritetit tonë intelektual që të theksojmë se edhe Profesdor Gjovalin Shurtaj konfirmoi pikërisht në konferencën shkencore, në vitin 209 në kuadrin e 367 vjetorit të shkollës së Kurbin, i cili në referatin e tij, duke u mbështetur dhe analizuar të folmen e Kurbin, më 1270 botuar nga ana jonë, kumtoi temën: Izoerge dhe Izoglosa të së folurës së Kurbin, në dritën e sociolinguistikës së sotme. Çuditërisht nuk e dimë se përse, por askush nga qarqet akademike në Shqipëri, nuk foli më tutje, për ti dhënë jetë këtyre artefakteve linguistike shqiptare me vlerë botërore e ndërkombëtare, të cilat e vendosnin gjuhën shqipe në panteonin e artë të kombeve të qytetruara që i takonte, me një vjetërsi qindra vjecare, si një nga gjuhët e shkruara indoeuropiane më të vjetra në botë.

Çuditërisht me gjithëse kishim shumë medio prezent, as media nuk tha asokohe asnjë fjalë, sikur askujt nuk i interesonte të dilnin në pah gjithë këto zhvillime të shqiptarëve nga kurbinasit. Në fakt, heshtja tregon Aprovim, por mos përjetësimi është Faj e mos atdhetari, çka i ka sjellë një dëm të jashtëzakonshëm kohor Etnohistorisë dhe Linguistikës kombëtare. Për të përvijuar në kumtimin e sotshëm, dhe për ti vënë kurorën, vjetërsisë së gjuhës shqipe dhe shtetformimit të shqiptarëve në Kurbin, madje dhe ekzistencës së Dinastisë qytetare kurbinase ndër shekuj, sigurisht, që është në nderin tonë të theksojmë sot, se për këtë shkak kurbinasi Papa Klementi i XI-të jo pa qellim, asokohe me 20 Prill të vitit 1711 urdhëroi të hapet Katedra e parë e gjuhës shqipe në Romën e qytetruar, mbasi atje kishte një plejadë Akademikësh dhe Teologësh shqiptar të vlerave ekselente, dhe disa Filiale të Universiteveve në gjuhën shqipe, të cilat i kishte ngritur jo pa qellim De Propoganda Fide e Romës osokohe si kundër ishin:

Hapjen e Kolegji Shqip të Shën Athanasit në Romë më 1572

Hapjen e Kolëghjit Ilirik të Loretos Më 1580

Hapjen e më pasme të Kolegjit të Fermos më 1633

Të gjithë studiuesit e dinë se nuk do të kishte mundësi kurrë nga askush të realizohej ky event ne Romën e qytetruar asokohe, për hapjen e Katedrës së parë të gjuhës shqipe atje, as nga Papa Klementi i XI-të si Mbret i 2.7 miliard të krishterëve nepër botë që ishte, po të mos kishte pasur shkollë shqipe më parë në Arbër, si bazë arsimimi kombëtar. Por Akademiku dhe Teologu kurbinas Gjon Francesk Albani e kishte shpjeguar stafit të vet, se për tu hapur katedër e Gjuhës Shqipe në Romë, domosdo ka ekzistuar më parë shkolla shqipe në Arbër, që para vitit 1270, pikërisht në Kishën e Shën'mërisë në Sebastie të Lacit në Kurbin, sepse kjo kishë administrohej prej shekujsh nga Vatikani. Është një kënaqësi e pa fund të shikojsh nepër arkiva, ku Albanologë të kombëve të ndryshme shpjegojnë shkencërisht e historikisht mbi bazën dokumentare, se me rënien e Perandorisë Bizantine, e cila në një farë mase kishte influencë edhe mbi Ilirinë e Hershme, fillë mbas kësaj rënie, disa nga Feudalët Kurbinas që kishin kapacitete, si kundër ishte familja e Jonimajve, në Kurbin, të cilët zotëronin një pjesë të madhe teritori e popullate, të udhëhequr nga Progon Jonima, morën iniciativën dhe guximin

që në shenjë humanizmi, atdhetarie dhe deshirëplotë për të rimëkëmbur emrin e Ilirisë së Humbur, ata të shpallin krijimin e shtetit të Parë Shqiptar të Arbërit, me Progon Jonimën në kryer në vitin 1190.

Kurbini u formua shteti i pari, Arbëri më 1190

Mbi bazën e këtyre dokumenteve provohet se nga Kurbini u formua shteti i pari, Arbëri më 1190. Prandaj kemi gjithë të drejtën e Zotit të pohojmë sot këtu para jush për herë të parë shkencërisht, se nga kurbinasit u formësua shteti i par i shqiptarëve, Shteti i Arbërit, madje dhe shkolla shqipe e Kurbinit, para vitit 1190, ashtu si deshmonte dikur Edit Durhan, Albanologia me famë botërore, pavarësisht se Skeptikët nuk duan që ta thon këtë fakt, vetëm për shkak se këtë madhësi për kombin shqiptar e kanë krijuar klerikët e krishterë kurbinas, por kjo është në dëm të racës shqiptare, sepse të gjithë e dinë se Raca shqiptare kanë patur si besim fillestar Paganizmin, pastaj ky popull kishte përqafuar shkallë - shkallë, Filozofinë e Krishterë e formësuar juridikisht kjo teologji fetare në vitin 325 në Koncilin e parë Ikomenik të Nikesë, ku ishte formësuar parimi bazë, i Krishtëritimit, i cili do të clironte njerëzimin nga Poligamia, Filozofi kjo që synonte rrenjosjen mes njerëzish të Dashurisë, Bashkëjetesës dhe Harmonisë njerëzore. Pikërisht kurbinasit paskeshin përqafuar që asokohe filozofinë e Krishterë deri në periudhën e pushtimit turk, që i detyroi ata pjesërisht me forcë të konvertoheshin në fenë e Islamizmit, e krijuar nga ushtaraku Muhamed në vitin 628 me pushtimin e MEKËS. Si Fe e lindur 578 vite më vonë se Krishtërimi. Ne besojmë se duke patur gjithë këto Artefakte shkencore për vlerat që ka ndër shekuj Kurbini Shqipëria ime, gjithkujt prej nesh nga studiuesit e ndershëm kombëtarisht, ju lind e drejta të pyesin vetveten:

1. Po përse dijetarët tanë i humbin kombit të tyre 752 vite vjetërsi të gjuhës së tyre të shkruar si një nga gjuhët më të vjetra Indoeuropiane në botë, por mjaftojnë të përmendin mësonjëtooren e shkollës shqipe të Korcës më 7 Mars të 1887-tës, duke i humbur kështu kombit të vet 752 vite Kulture Linguistike deri më sot?! Ku është Akademia e shkencave të shqipërisë që nuk gjegjet për përgjegjësinë që ka ndaj kombit të vet.

2. Ne tashma e dime, nga dokumentet arkivore historike në Vatikan, se Shteti i par i Arbërit qenka formuar në Kurbini më 1190 –dhe paska patur një jetëgjatësi deri më 1271 për 81 vite, jetë, si asnjë kryeshtetas tjetër në shqipëri, por ne u dashka që të zhvendosemi për të përcaktuar shtetin e par shqiptar në vitin 1912, duke i humbur kombit tone 832 vite shtet ,sepse studiuesit e dinë mirë, se kombi shqiptar ka patur shtet edhe më 1190, pastaj më 1450 me Legjendarin kombëtar Gjergj Kastriotin deri në ripushtimin e shqipërisë serish nga Turqit e pastaj më 1912 nga Ismail Qemali , aq pak sa ishte, e më vonë nga Mbreti Zog duke u përvijuar me clirimin e shqipërisë më 1944 nga Ushtria Nacionale Clirimtare. Atëhere na lind pyetja e quditëshme:

3. Po pse ne i humbim vetvetës si komb 832 vite shtet kombëtar, që nga viti 1190 e deri më sot në vitin 2022.

Vërtetë faktet janë rrënjëqethëse por duhet thënë se nuk ka asgjë të pa riparueshme, sepse në konceptin tonë: asnjëherë s’duhet thënë kurrë, asnjëherë mos thuj se është vonë.

Parë në këtë kendveshtrim, duhet të rikujtojmë se dijetarët tanë sot në demokraci, ata e kanë mendimin e lirë për ta thënë fjalën e vyer të tyre për kombin e vet, atëhere pse këta nuk njohin dhe nuk pranojnë historinë kombëtare të etërve të tyre. Prandaj ne kemi cituar në krye të kësaj teme se: Kurbini është një oaz vlerash i pa vlerësuar kombëtarisht, e kur studiuesit nuk vlerësojnë dhe pranojnë historinë e etërve të tyre, ata shtreberojnë të vërtetën dhe humbin Identitetin dhe madhësitinë e kombit të vet. Përshtetë jam i vendosur të mos lodhem dhe të mos hesht kurrë, për të ngritur zërin për vlerat Etnohistorike, Linguistike, dhe qytetuese kombëtare, për vendlindjen time, sepse të gjithë duhet të besojnë se përshtetë i përkas asaj plejade intelektualësh që sosin terë jetën e pasurinë e tyre për At’Dhetari, në këtë shqipërinë tone të Artë, duke hargjuar tërë kohën dhe pasurine e vet, për te nxjerrë

në pah vlerat kombëtare të racës së artë shqiptare. Prandaj ne kemi gjithë të drejtën e Zotit të themi sot me plot gonën para jush, të vërtetën, që ta marrin vesh të gjithë shqiptarët e bota mbarë se:

1. Kurbini ka pasur qytetrimin e tij që nga shekulli i tretë para Krishtit, me një dinasti solide qytetare për kohën, sepse nuk do të kishte mundësi që ndër vite e shekuj nga Kurbini të dilnin gjithë ato figura ekselentësh kombëtar e Botëror.

2. Kurbini është vatra nga ku u formua shteti i parë i Arbërit më 1190, me Progon Jonimën kurbinas në krye. Pikërisht për këtë arësyje popullsia Autoktone, Etnokultura, Etnohistoria e Linguistika e Kurbinit mbeti e pastërt dhe e pa prekur, deri në vitin 90. Themi kështu, sepse Regjioni i Kurbinit është i vetmi në shqipëri që ka 6 kostume të vecanta për grad he tre costume pwr burra. Ka 5 kështjella qytetuese dhe Dialektologjinë e saktë burimore të saj me burime Linguistikë nga mësonjëtorja e vitit 1270, ndërsa quditërisht, të ardhurit në këtë vend, mundohen që të asimilojnë Linguistikën vendase, kostumografine kurbinase me atë të Pukës e Mirditës, një fatkeqësi kombëtare kjo, për shkak të Partiokracisë militante të ardhur mba Mirdita e Puka në pushtetin vendor, madje dhe neglijencës së studiuesëve autoktonë kurbinas për ta ngritur zërin në mbrojtje të pasurisë Etnokulturore, Etnohistorike dhe Linguistike kombëtare.

3. Kurbini, në mënyrë të pa diskutueshme historikisht e shkencërisht, është vatra e mësonjëtores së parë shqipe në Kishën e Shënmerisë në Sebastie të Lacit që në vitin 1270. Mësonjëtorë kjo, që nxori Seminaristët e parë në gjuhën shqipe të paktën që në vitin 1270 e deri në vitin 1641, prandaj kësaj i përket të citohet si shkolla e parë shqipe dhe jo ajo e Korçës më 1887, 617 vite më pas, duke i humbur kombit tonë 617 vite vjetërsi, cka do ta kishin zili kobet e qytetruara të sotëshme, të krijuar pas nesh.

4. Nga dinastia qytetare Kurbinase doli Shejti dhe Papa Klementi i XI-të, Gjon Francisco Albani, i cili formoi në Romën e qytetruar në vitin 1711 Katedrën e parë të Gjuhës Shqipe, sepse po të mos kishte patur shkollë shqipe Kurbini, nuk do të kishte ai mundësi të shkollohej dhe të bëhej kryezot i Krishtërimin.

5. Kurbini si asnjë Regjion tjetër, ka Dy shejtër, Papa Klementin dhe Gjec Vlashin kurbinas, si asnjë Regjion tjetër në shqipëri.

6. Kurbini ka koselacionin e bamirësisë njerëzore më të madhe në botë, Vendflijimin e shejtit kurbinas Vlash me 40 murgjit e tij, që më 1231 në shpellën e masakrimin nga barbarët, Koselacion ky bamirësi njerëzore për më se 789 vitesh. Si mbas një studimi që kemi bërë, na del se eshtërat e shejtit Vlash nga Kurbini, me pushtimin e shqipërisë nga turqit janë shenime të sakta se klerikët kurbinas me qellim mios bjerrjen e eshtrave të shejtit të tyre ata e gërmuan varrin dhe mbasi I paketuan eshtrat e shejtit të tyre ata i nisën për në Itali. Në arkivin e Vatikanit kemi gjetur një shenik në të cilin thuhet se:

Eshtnat e Shnavlashit kanë qenë në fillim të vendosuna në Sebastie të Albanisë, por me pushtimin e parë të shqipëqrisë prej turqve ato u dërguan në Raguzë të Italisë. Mbi të cilën nuk dimë se përse u mënjanuar Kisha e Shënmerisë nga Vatikani, e mbi këtë u ndërdua dhe u shuguirua 423 vjet më vonë, Kisha e Shnandoit të Padovës më 2 dhjetor të vitit 1557.

1. Nga Kurbini kanë dalë figura të Hirarkisë së lartë të Krishtërimin si Teologë dhe Akademikë mbi 20 Ipeshkëv, dy shejtër dhe një papë, si Klementi i XI-të, si në asnjë Regjion tjetër në shqipëri.

2. Kurbini tashma falë nesh, ka një muze Etnohistorik me mbi 300 monumente të Natyrës dhe Etnohistorisë dhe Etnokulturës Regjionale e Kombëtare.

3. Ne kemi mundur që me shumë dhimbje të botojmë edhe Enciklopedinë e Kurbinit prej 250 faqesh, në të cilën jepet edhe e para dialektologji e Regjionit të Kurbinit, variant i së folurës së vitit 1270, ku fatkeqësisht asnjë kopje të saj nuk kanë shkollat tona, e Ministrisë së Arsimit, madje as drejtorisë arsimore në rreth as që ju ka rënë ndërmend për këtë fenomen.

4. Për këto e shumë vlera të tjera të thëna e të pa thëna deri më sot, ne është e treta herë që i drejtohem Selisë së shejtë për ta shpallur Lacin “QYTET TË SHEJTË” duke patur në konsideratë, se nuk i jepet

popullit besimtar shejtërimi, sepse popujt shkojnë e vijnë ndër vite e shekuj në një teritor, por shejtërimi i jepët kësaj toke të shejtë dhe flijimit të njerëzve të saj për madhësi Atdhetare dhe humanizëm e bamirësi njerëzor. Tani është momenti ti lutemi kombëtarisht, si bir i këtij vendi në Kurbin, Mansinor Dodajt, i lindur në Lac, të japë kontributin e tij në Selinë e shejtë e të fillojnë përgatitjet, që kjo tokë e shejtë, Laci të shpallet nga Vatikani QYTET I SHEJTË, sepse ky do të jetë edhe nderi më i madh që i bëhet kombit nga ana tij, duke formuar në këtë kontinent të Krishterësh, një Vend të Shejtë të Krishtërimt.

ILUSTIMI ME FOTO I KUMTESËS

Në këtë kuvend ne paraqitën të gjitha vlerat etnohistorike dhe Etnokulturore e Linguistike shtetformuese të kurbinasve ndër vite e shekuj.



Fig. - 5 Kalaja e latios në lac të kurbinit e ndërtuar që në shekullin e tretë para krishtit




Fig. – 6 Kalaja e sebasties në lac të kurbinit e ndertuar mbi themelet ekalasë së latios mbas shembjes së saj nga barbarët




Fig. - 7 Kalaja e ilirët kurbinas që në mesjetën e

shkopetit e ndërtuar nga hershme.



Fig. – 8 Kalaja e tanushit e ndërtuar nga kurbinasit aty rreth vitit 1400 në daul të kurbinit



myslimane



Fig. - 9 Kostumi i gruas

Fig. – 10 Ky është brezi me rrema

Ja konkretisht ish veshja e gruar myslimane mbas vitit 1500 i cili përdfori edhe brezin me rrema të gruas kurbinase në mesjetën e herëshme. I cili është i punuar me afërsisht 50 fije gajtanash të dimensioneve me 30 fije tjerrjesh me një gjatësi mesatare prej 4 metrash të gjata, të cilët që në mesjetën e herëshme e kanë përdorur gratë kurbinase mbështjellë rreth belit të tyre. Duhet thënë se ky lloj brezi kishte dy qëllime:

Së parit ai kishte qëllim zbukurimin e belit të gruas. Së dyti ky brez shërbente edhe për mbrojtjen e temperaturave të ftohta që ka pasur Kurbini ndër shekuj. Mbas pushtimit turk dhe të konvertimit të disa kurbinasve në myskiman, gruaja myslimane e mori në koastumin e saj të nusërisë, dhe që u përdor edhe nga vajzat e martuara myslimane tek zona e Burrelit në atë kohë. Ky relik mijëra vjecar ruhet edhe sot e kësaj dite në Muzeun Etnohistorik NIDA të Kurbinit në Lac.



Fig. – 11 Kjo është një veshje e gruas qytetare në divas të kurbinit të cilët kishin emigruar në greqi në vitin 1232.



Fig. - 12 Shqiponja ne qeramikë

Karakteristike në këtë fustan, përveqse një xhakete me motive interesante, në gjoksin e tij ai mban edhe një vizartim të një shqiponje me kokë njeriu, variant të saj ne e jemi gjetur në vitin 1946 në disa gërmime në rrenojat e shtëpive të qytetit të Divasve në Lac të Kurbinit të pjekur në një qeramikë ku shkruhej: Divas Sevastus 540, si një emblem e këtij qytetrimi të hershëm në kurbin.



Fig. - 13 Ky është kostumi i gruas qytetare të divasve ne vitin 1231, përdorur nga dinastia qytetare e divasve asokohe.

edhe sot në muzeun etnohistorik *nida* në lac të kurbinit.



Fig. - 14 Ky është kostumi më i vjetër i arbërit që në mesjetën e hershme që e ka përdorur gruaja e katundit zhejë në kurbin, i cili gjendet



Fig. - 15 Ky është kostumi i katundit lac në kurbin i përdorur për nusërimin e vajzave kurbinase mbas pushtimit turk.

Fig. - 16 Kjo është veshja e nuses së fshatit gallatë në kurbin që pas pushtimit turk e deri më sot.





Fig. - 17 Kjo është veshja e nusesmyslimane mbas pushtimit turk, kostum ky që gjendet në muzeun etnohistorik *nida* në lac të kurbinit edhe sot.

Fig. - 18 Ky është kostumi i dinastisë së burrave kurbinas vitit 540 në qytetin e divasve në lac të kurbinit i gjetur në koropi të greqisë i ruajtur nga divasit e merguar atje që në vitin 570.



Si kundër shikohet ky kostum, ndryshe nga kostumi Lab me fustanellë ky nuk e ka fustanin të bardhë si ai I labërisë por e ka me punime tezgjahu. Madje Dollama e tij kreshnike është e vecantë në shqipëri, e cila dallohet për nga ornamented nga të fgjitha llojet e veshjeve të tjera kombëtare. Prandaj kemi thënë se Kurbini është një Oaz vlerash Etnokulturore. Etnohistorile, Linguistike dhe Shtetformuaese si asnjë Regjion tjetër në Shqipëri që deri tani nuk i është dhënë vendi i merituar në Etnohistorinë kombëtare.




Fig. - 19 Ky kostum është përdorur nga paria e burrave në të gjitha katundet e kurbinit që nga viti 1450 e deri më sot.

Duhet theksuar se ndryshe visheshin burrat dhe gratë kurbinase nepër dinastitë e kështjellave dhe ndryshe visheshin gratë e katundarëve në zonën e Kurbinit.

Fig. - 20 Ky është kostumi i burrave në të gjithë katundet e kurvinit në vitin 1100- asokohe kur sapo kishte filluar emigrimi për ne greqinë e lashte, si shkak i pushtimeve.



Fig. - 21 Kjo është emblem e familjes albani, të cilën e ka pas përdorur mapedani i kurbinit mikel laci që para periudhës kur ai ishte komandar në usahtrinë e skendërbeut, pataj kjo utrashigua nga familja albani në urbino të italisë.



Fig. - 23 Kjo emblemë ka qenë e Stërplakut kurbinas, Mhill Leshi nga Vablini i Kurbinit, e cila është trashiguar deri në vitin 2022 nga pasardhësit e tij familja *NIDA* në Lac të Kurbinit. Me emërtesën STËRPLAK, kurbinasit emërtonin ndimësin apo këshilltarin e plakut të katundit, I cili kishte tagër të jepte mendime në pleqësinë e katundeve.

Fig. - 22 Emblema e qytetit të divasve në lac të kurbinit-



540



Fig. - 23 Kjo stemë është gjendur në një gërmim në divas në vitin 1979 e stamosur në një enë qeramike. por për këtë emblem është folur në vatican nga një murg anonim që thoshte se kjo ka qenë stema e pare e shtetit të arbërit në kurbin. në fakt kjo është e ngjashme me

vizatimin e emblemës së Divasve, prandaj edhe ka të ngjarë që të jetë përdoror nga shteti i Arbërit si element kurbinas.

PËRFUNDIME

1. Së parit duhet theksuar se Kurbini ka 4 kështjella të njohura historikisht deri tani.
2. Kurbini ka një histori të vjetër qytetruese që nga shekulli i tretë para Krishtit në Kalanë e Latios në Lac.
3. Nga Dinastia qytetare e Divasve në Kurbin u formua shteti i pare i Arbërit më 1190 - 1271 për 81 vite shtet me princin kurbinas Progon Jonima në krye.
4. Mbas shembjes nga Barbarët të Latios, aty rreth viteve 527-567 në Lac u ndërtua qyteti i Divasve.
5. Divasasi ka pasur një princ të quejtur Sebastian, një Gjukatës nga Venediku.
6. Nga Divasi i Kurbinit , më vonë në vitin 1464 ka dalë një figurë e rrallë kurbinase Kapidani ushtarak kurbinas në ushtrinë e Skendërbeut Mikel Laci , titull ky që ja dha Vatikani nepërmjet qeverisë së asokohëshme të Romës.
7. Nga kurbini kanë dalë 20 figura të mëdha të përbotëshme klerikësh dhe shtetformuesish.
8. Kurbini ka si asnjë Regjion tjetër në Shqipëri, dy shejtër dhe një Papë.
9. Nga Dinastia qytetare në Divas të Lacit ka dalë Intelektuali i përbotshëm Gjon Francesk Albanio Papa Klementi XI, i cili hapi për herë të parë Katredrën e Gjuhës shqipe në Romë me 20 Prill 1711.
10. Kurbini ka fatin e saj ,se që në vitin 1270 e deri në vitin 1641 në kishën e shënmërisë në Sebastie të Lacit ka pasur shkollën shqipe për 371 vite.
11. Kurbini, si asnjë Regjion tjetër në shqipëri, ka Dialektologjinë e saj të kodifikuar sipas së folusës së vitit 1270 në kishën e Sebasties në Kurbin dhe të botuar prej nesh, e cila është berë tekst universitar.
12. Kurbini ka Koselacionin e bamirësisë njerëzore ma të famshmin në botë, vendflijimin e Valashit Kurbinas me 40 murgjit e kësaj kishe në Sebastie.
13. Si kundër shikohet, Shteti i Arbërit përdori emblemën e qytetit të Divasve, por të stilizuar në një formë tjetër. E rëndësishme është se kjo shqiponjë me kokë njeriu u ripërsërit nga shteti i Arbërit, por nuk u ripërsërit nga Skendërbeu. Sepse në flamurin e Skendërbeut, shqiponja nuk u pasua me kokë njeriu, por me dy krena të një zogu të shqipes, ndoshta kjo për shkak se Arbëri që me pushtimin e Perandorisë Osmane u copëzua në dy pjesë.
14. Fatmirësisht si në asnjë Regjion tjetër në shqipëri, Kurbini, në saje të një qytetrimi të hershëm solli nga thellësia e shekujve 7 Kostume për gra dhe 3 Kostume për Burra.
15. Së këndejmi shikohet se Regjioni i Kurbinit si asnjë Regjion tjetër në Shqipëri, Kurbini që në lashtësi ka ardhur duke i shtuar kostumet sipas zhvillimit të qytetrit të rajonit të vet, në të gjithë teritorin e vet deri në ditë e sotëshme në Shtatë kostume për gra dhe tre kostume për burra. Gjithashtu ka patur edhe katër emblema të rëndësishme qytetruese e shtetformuese, përfshisë këtu edhe emblemën e Shtetit të Arbërit formuar në Kurbin më 1190 nga kurbinasi

Progon Jonima. Kjo ndër shekuj ka ndodhur sepse Kurbini ka qenë i përberë gjatë gjithë shekujve nga kategori të ndryshme njerëzish. Ka pasur kostume për Dinastinë qytetare, Kostume për vegjëlinë qytetare, kostume për pleqësinë e katundeve, madje pothuaj se cdo katund kishte për gra një kostum të vecantë, shto këtu edhe kostumin e gruas myslimane mbas konvertimit të tyre në myslimanësia.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Edit Durhan *Studime Albanologjike shekulli XIII ,. Arkivi shkencor i Institutit të Gjuhës Tiranë si edhe A.Q. Vatikan. Relacione kishtarë të vitit 1641. Vol.II.f.-304-326.
2. Edit Durhan *Studime Albanologjike shekulli XIII. Arkivi shkencor i Vatikanit burime kishtarë për Albanologjinë Romë.
3. A.Q.SH Romë.Arkitektura shqiptare e mesjetës.
4. Gullielmus Adae,Direktorium and Passagium Facenda as terram sanedam Dosja Adae=1332
5. (Directorium an passagium facientda libri i parë, pjesa 8,A.Q.Vatikan-Romë.
6. Gjeografia shqiptare. Libri III.f.40 -70
7. Vatikan. Relacione kishtarë të vitit 1641. Vol.II.f.249-301
8. Relacione kishtarë vol.I. Vatikan.
9. (Directorium an passagium facientda libri i parë, pjesa 8,A.Q.Romë.
10. (Aechivio di stato, Milano, Cartegg. Sifarze sco, Albania, Dosja 147.
11. (Directorium an passagium facientda libri i parë, pjesa 8,A.Q.Romë.
12. ILIRICUM Sacrum,vol.vII.f.124.